REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 23 dhjetor 2025
Nr. ref.: AGJ 2925/25

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI81/25

Parashtrues

Adem Shehu

Vlerësim i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës në lëndën civile T.nr.29/2000 nga Gjykata Themelore në Gjakovë

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Nexhmi Rexhepi, kryetar
Safet Hoxha, zëvendëskryetar
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Adem Shehu nga Komuna e Gjakovës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Teki Bokshi, avokat në Komunën e Gjakovës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore të zhvilluara pranë Gjykatës Themelore në Gjakovë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore) përkitazi me lëndën civile [T.nr.29/2000] (lëndë e cila me ndryshimin e numrit nga Gjykata Themelore identifikohet si në vijim [T.nr.125/2009], por Gjykata do t'i referohet me numrin [T.nr.29/2000]) .

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kësaj kërkese është vlerësimi i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurave të zhvilluara pranë Gjykatës Themelore, me pretendimin se ndërprerja e procedurës në lëndën [T.nr.29/2000] nga Gjykata Themelore cenon të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me dispozitat e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 1 prill 2025, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën përmes postës elektronike në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 7 prill 2025, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, përmes Vendimit [Nr. GJR. KI81/25], e caktoi gjyqtarin Radomir Laban, gjyqtar raportues, ndërkaq përmes Vendimit [nr. KSH. KI81/25], e caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Nexhmi Rexhepi (kryesues), Enver Peci dhe Jeton Bytyqi (anëtarë).

7. Më 28 prill 2025, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës, si dhe kërkoi nga i njëjti që të parashtrojë në Gjykatë dokumente shtesë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh.

8. Në po të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi Gjykatën Themelore për regjistrimin e kërkesës, mundësinë e ofrimit të komenteve, si dhe të njëjtës i parashtroi pyetje në mënyrë që të ketë pasqyrë të plotë lidhur me informatat përkitazi me çështjen. Nga Gjykata Themelore në Gjakovë u kërkua që përgjigjet në pyetjet e parashtruara, si dhe komentet eventuale përkitazi me kërkesën e parashtruar, t'i deponojë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh.

9. Më 2 maj 2025, Gjykata Themelore kërkoi afat shtesë për parashtrimin e përgjigjeve të tyre në pyetjet e Gjykatës meqë gjyqtarja e rastit gjendet në pushim vjetor deri më 18 maj 2025 dhe lënda është e vjetër dhe shtyrja e afatit nevojitet për dhënien e përgjigjeve të sakta.

10. Më 5 maj 2025, Gjykata e njoftoi Gjykatën Themelore se aprovohet kërkesa për afat shtesë në parashtrimin e përgjigjeve, marrë parasysh se është e nevojshme dhe në interes të drejtësisë për shqyrtimin e rastit në fjalë, duke kërkuar nga e njëjta që përgjigjet t'i deponojë në afatin prej 10 (dhjetë) ditësh nga data 18 maj 2025.

11. Më 6 maj 2025, Gjykata pranoi dokumentet shtesë të kërkuara nga parashtruesi i kërkesës, respektivisht (i) Aktvendimin [C.nr.314/2001] e 6 majit 2002 të Gjykatës Komunale; (ii) Aktgjykimin [Civ.nr.279/97] e 9 korrikut 1997 të Gjykatës Komunale; (iii) Aktgjykimin [Gzh.nr.480/98] e 7 tetorit 1998 të Gjykatës së Qarkut në Pejë; si dhe (iv) Aktvendimin [AC.nr. 40/2002] e 1 shkurtit 2006 të Gjykatës së Qarkut në Pejë.

12. Më 14 maj 2025, Gjykata pranoi nga Gjykata Themelore përgjigjet në pyetjet e parashtruara përkitazi me rastin.

13. Më 29 korrik 2025, Gjykata sërish i parashtroi kërkesë për informata shtesë Gjykatës Themelore.

14. Më 4 gusht 2025, Gjykata Themelore kërkoi afat shtesë për parashtrimin e përgjigjeve të tyre, të cilin ia aprovoi Gjykata.

15. Më 28 gusht 2025, Gjykata pranoi nga Gjykata Themelore përgjigjet në pyetjet e parashtruara përkitazi me rastin.

16. Më 11 dhjetor 2025, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata, njëzëri: (i) deklaroi kërkesën të pranueshme; (ii) konstatoi se ka pasur të paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, përkitazi me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm; dhe (iii) urdhëroi Gjykatën Themelore në Gjakovë, që jo më larg se më 11 mars 2026, të informojë Gjykatën Kushtetuese lidhur me masat e ndërmarra për zbatimin e këtij Aktgjykimi, në pajtim me paragrafin 5 të rregullit 60 të Rregullores së punës.

Përmbledhja e fakteve

17. Më 7 nëntor 2000, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatën Komunale në Gjakovë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Komunale) kërkesë për zbatimin e procedurës së trashëgimisë të lënë pas nga nëna e tij, [N.SH.]. Përmes kërkesës, parashtruesi i kërkesës kishte deponuar dëshminë e vdekjes së [N.SH], si dhe e kishte informuar Gjykatën Komunale se ka ndërruar jetë edhe [M.SH], i biri i [N.SH]. Në përmbajtje të kërkesës për zbatimin e procedurës trashëgimore janë listuar katërmbëdhjetë (14) trashëgimtarët e radhës së parë trashëgimore, të drejtpërdrejtë dhe sipas bazës së përfaqësimit.

18. Nga shkresat e lëndës rezulton se, masa trashëgimore e [N.SH] përbëhet nga paluajtshmëritë e evidentuara në fletën poseduese nr. 1371, KK Gjakovë-qytet, respektivisht ngastrat kadastrale nr. 2513/1 dhe 2613/2, me kulturë si në fletën poseduese, në sipërfaqe të përgjithshme prej 0.06.64 ha dhe ato të evidentuara në fletë poseduese nr.26 KK Zidi Sadik Ages II nr.21, 22/1, 22/4, në sipërfaqe të përgjithshme prej 0.70.53 ha, me kultura si në fletën poseduese në fjalë.

19. Përmes kërkesës së lartcekur për zbatimin e procedurës së trashëgimisë, parashtruesi i kërkesës e informoi Gjykatën Komunale se janë zhvilluar konteste gjyqësore pronësore që kanë të bëjnë me paluajtshmëritë e sipërcituara në lëndët: (i) [C.nr.297/97]; (ii) [C.nr. 240/96] (për çka, në kërkesën drejtuar Gjykatës e informon se numri aktual i të

njëjtës është 688/97); si dhe (iii) [E. 433/97]. Përkitazi me këtë, parashtruesi i kërkesës shtoi se kontesti në lëndën [C.nr.688/97] i takon natyrës së pengim posedimit, që nuk ka ndonjë ndikim në procedurë, ndërkaq kontesti [Civ.nr. 279/97] ka përfunduar me vendim të formës së prerë.

20. Më 1 shkurt 2002, Gjykata Komunale, përmes Aktvendimit [T.nr.29/2000], e ndërpreu çështjen juridike lidhur me procedurën e trashëgimisë deri në përfundimin e procedurave në lëndët [Civ.nr.279/97] dhe [Civ.nr.314/2001] (lëndë e cila me ndryshimin e numrit nga Gjykata Themelore identifikohet si në vijim [C.nr.145/2012], por Gjykata do t'i referohet me numrin [C.nr.314/2001]), që ndërlidhen me ngastrat kadastrale të specifikuara në propozimin e parashtruesit të kërkesës për zbatimin e procedurës trashëgimore.

21. Në arsyetimin e Aktvendimit të sipërcituar të Gjykatës Komunale u potencua se është bërë shikimi dhe leximi i lëndës së rekonstruar [Civ.nr.297/97], me paditëse [N.SH] kundër [A.SH], për prishje të kontratës mbi dhuratën Leg.nr. 237/96 të 1 marsit 1996, lidhur me ngastrat kadastrale sipas fletëposedimeve nr. 26 KK Zidi i Sadik Agës dhe fletëposedimit nr.1371 KK Gjakovë-qytet, të cilat janë potencuar si pasuri trashëgimore të Nazife Shehut. Tutje, Gjykata Komunale theksoi se *"Me Aktvendimin Civ.nr.279/97 të dt.21.dhjetor 2001 është vërtetuar se është bërë përtrirja e shkresave të lëndës Civ.nr.279/97, por Aktvendimi nuk është i plotëfuqishëm"*.

22. Më tej, përmes këtij Aktvendimi, lidhur me lëndën [Civ.nr.314/2001], Gjykata Komunale theksoi se "*Gjykata bëri shiqimin dhe leximin në shkresat e lëndës Civ.nr.314/2001 të kësaj Gjykate, të pranuara në Gjykatë me 27.korrik 2001 ku paditës është [A.SH] ndërsa të paditur [A], [H], [F] Shehu, Adem Shehu dhe [A] Shehu, ku kërkohet të vërtetohet se paditësi Aliu është pronar i paluajtëshmërive sipas fletëposedimeve nr.26 KK Zidi i Sadik Agës dhe fletëposedimit nr.1371 KK Gjakovë-qytet. Lënda e cekur është në procedurë"*.

23. Sipas arsyetimit të Gjykatës Komunale, deri në përfundimin juridik se procedura duhet të ndërpritet erdhi pasi *"pasuria trashëgimore është kontestuese konform nenit 127 parag.2 të Ligjit mbi procedurën jashtkontestimore u vendosur si në dispozitiv të këtij Aktvendimi"*.

24. Më 9 shkurt 2002, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Qarkut kundër Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Komunale, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës civile, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Përmes kësaj ankese, parashtruesi i kërkesës pretendoi se lënda [Civ.nr.279/97] ka përfunduar me vendim të formës së prerë, ndërkaq lidhur me lëndën [Civ.nr.314/01] potencoi se fakti se trashëgimtari [A.SH] ka paraqitur padi nuk paraqet bazë për ndërprerje të procedurës.

25. Përmes Aktvendimit [Ac.81/2002], Gjykata e Qarkut në Pejë e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruar dhe vërtetoi Aktvendimin e lartpërmendur të Gjykatës Komunale.

26. Më 2 tetor 2009, përmes parashtresës së natyrës së urgjencës drejtuar Kryetarit të Gjykatës Komunale, parashtruesi i kërkesës kërkoi që të zhvillohet procedura e lartcekur në lëndën e iniciuar në vitin 2000.

27. Më 27 mars 2025, parashtruesi i kërkesës përmes parashtresës e njoftoi Gjykatën Themelore se nga paraqitja e kërkesës për shqyrtimin e trashëgimisë, kanë vdekur edhe një pjesë e trashëgimtarëve të trashëgimlënëses [N.SH], specifikoi renditjen e trashëgimtarëve të mbetur e që rezulton se numri i trashëgimtarëve sipas radhës së parë

trashëgimore dhe sipas bazës së përfaqësimit është 29 (njëzetenëntë). Parashtruesi i kërkesës po ashtu kërkoi caktimin e seancës për shqyrtimin e trashëgimisë.

28. Më 8 prill 2025, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata Themelore që me urgjencë ta caktojë seancën.

Përmbledhja e fakteve në procedurat kontestimore pranë Gjykatave të rregullta

(a) përmbledhja e fakteve përkitazi me procedurën për anulimin e kontratës për dhurimin e pasurisë së paluajtshme në lëndën [C.nr.279/97]

29. Më 9 korrik 1997, Gjykata Komunale, përmes Aktgjykimit [Civ.nr.279/97], e anuloi kontratën [Ov.nr. 237/96] e 1 marsit 1996 për dhurimin e pasurisë së paluajtshme, të lidhur mes [N.SH], në cilësinë e dhurueses dhe [A.SH], në cilësinë e marrësit të dhuratës. Kontrata e dhurimit në fjalë ishte lidhur për *"parcelën kadastrale nr. 21, me kulturë ndërtesë - pleh, në sipërfaqe prej 25 m², nr. 21, me kulturë varreza, në sipërfaqe prej 805 m², nr. 22/1, me kulturë varreza, në sipërfaqe prej 3,324 m², nr. 22/4, me kulturë livadh, në sipërfaqe prej 2.904 m², sipas fletës poseduese nr. 43. ZK Zidi i Sadik Agës, nr. 2513/2, me kulturë ndërtesë, në sipërfaqe prej 152 m², oborr me sipërfaqe prej 131 m², sipas fletës poseduese nr. 1371, Zona Kadastrale Gjakova – Qytet"*.

30. Në një datë të paspecifikuar, [A.SH] paraqiti ankesë në Gjykatën e Qarkut në Pejë kundër Aktgjykimit të 9 korrikut 1997 të Gjykatës Komunale.

31. Më 7 tetor 1998, Gjykata e Qarkut në Pejë, përmes Aktgjykimit [Gzh.nr.480/98], e refuzoi si të pabazuar ankesën e [A.SH] dhe e vërtetoi Aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Komunale.

32. Më 12 dhjetor 2000, paditësja [N.SH] parashtroi kërkesë për rekonstruimin e shkresave të lëndës, me arsyetimin se shkresat e lëndës kanë mbetur në Serbi, kjo pasi që lidhur me këtë çështje është parashtruar revizion në Gjykatën Supreme të Beogradit ndaj vendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, e cila kishte refuzuar ankesën e paditëses kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Gjakovë.

33. Më 21 dhjetor 2001, Gjykata Komunale, përmes Aktvendimit [C.nr.379/97], i përtëriu shkresat e lëndës në rastin [Civ.nr.279/97].

34. Në një datë të paspecifikuar u parashtrua ankesë ndaj Aktvendimit të sipërcituar, porse Gjykata e Qarkut në Pejë, përmes Aktvendimit [AC.nr.40/2002], e refuzoi si të pabazuar.

35. Më 22 shkurt 2008, gjyqtari i çështjes përmes një shkrese i është drejtuar shkrimores në Gjykatën Komunale që të arkivohet lënda, pasi është përfunduar procedura sipas kërkesës për rekonstruimin e shkresave të lëndës.

(b) përmbledhja e fakteve përkitazi me procedurën për vërtetim të pronësisë në lëndën [C.nr.314/2001]

36. Më 27 korrik 2001, [A.SH] parashtroi padi për vërtetim të pronësisë kundër të padituve: [A.SH], [H.SH], [F.SH] dhe Adem Shehu.

37. Më 6 maj 2002, Gjykata Komunale, përmes Aktvendimit [Civ.nr.314/2001], e pushoi procedurën për vërtetim të së drejtës së pronësisë dhe specifikoi se *"Vazhdimi i procedurës mund të kërkohet nga palët pasi të skadojn 3 muaj nga data kur ka filluar pushimi. Poqëse, asnjëra palë mbrenda afatit 6 muajsh, nga data kur ka filluar pushimi i procedurës nuk paraqet propozim për vazhdim, konsiderohet se padia është e tërhjekur"*.

38. Më 11 dhjetor 2009, pas kërkesës së paditësit, Gjykata Komunale mori aktvendim për ndërprerje të procedurës derisa Gjykata Kushtetuese të vendosë lidhur me kërkesën për vlerësim të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë në rastin KI52/09, e cila është konsideruar si çështje paraprake për vendosje meritore të kontestit lëndor.

39. Tutje, në këtë çështje është parashtruar kërkesa e datës 24 prill 2012 për vazhdimin e procedurës së ndërprerë, ku më pas procedura ka vazhduar duke marrë numër të ri të lëndës dhe atë [C.nr.145/12].

40. Më 30 dhjetor 2012, sërish është nxjerrë Aktvendim për ndërprerje të procedurës për shkak të vdekjes së të padituri [A.SH] dhe nuk është vazhduar më.

41. Lënda në këtë çështje kontestimore vazhdon të jetë e arkivuar, ndërsa nga shkresat e lëndës rezulton se nuk ka asnjë kërkesë për vazhdim të procedurës së ndërprerë dhe se nuk është ndërmarrë ndonjë veprim për vazhdim të së njëjtës. Rrjedhimisht, kjo lëndë nuk ka përfunduar ende me ndonjë vendim meritor.

(c) përmbledhja e fakteve përkitazi me procedurën për vërtetim të pronësisë në lëndën [C.nr.93/20]

42. Më 29 janar 2020, [M.SH] paraqiti padi për vërtetim të së drejtës së pronësisë në paluajtshmërinë e cila evidentohet në emër të [N.SH], trashëgimlënëses së parashtruesit të kërkesës.

43. Më 2 maj 2025, në këtë lëndë është ndërprerë procedura deri në vendosjen e formës së prerë të lëndës [T.nr.29/2000].

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

44. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të drejtës së tij të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së).

45. Parashtruesi i kërkesës në procedurën para Gjykatës ka ofruar në mënyrë kronologjike përmbledhjen e procedurës, duke theksuar se procedura e trashëgimisë, e cila ka filluar më 7 nëntor të vitit 2000, nuk ka përfunduar ende dhe ka kaluar një periudhë të konsiderueshme kohore prej rreth 25 vitesh, duke tejkaluar çdo afat të arsyeshëm për një proces të drejtë dhe të shpejtë, duke i konsideruar vonesat dhe ndërprerjet e përsëritura si shkelje të së drejtë për gjykim në afat të arsyeshëm, të cilat cenojnë seriozisht të drejtat e tij.

46. Përkitazi me ankesën e ushtruar ndaj Aktvendimit [T.nr.29/2000] të Gjykatës Komunale, përmes së cilës është ndërprerë procedura e trashëgimisë, parashtruesi i kërkesës thekson se me përfundimin e lëndës civile [Civ.nr.279/97] nuk ka asnjë bazë ligjore që mund të justifikonte ndërprerjen e procedurës trashëgimore. Sipas parashtruesit të kërkesës, *"Kjo ka ngritur dyshime mbi ligjshmërinë e vendimit të ndërprerjen dhe ka kërkuar vazhdimin e procedurës së trashëgimisë, për të siguruar që pasuria të ndahet sipas të drejtës dhe kërkesës së trashëgimtarëve"* .

47. Më tej, parashtruesi i kërkesës thekson se asnjëherë nuk është caktuar një seancë gjyqësore për shqyrtimin e çështjes, përkundër faktit se palët kanë paraqitur disa kërkesa urgjente për caktimin e seancave. Në vijim të këtij pretendimi, parashtruesi i kërkesës thekson se pasi kjo procedurë është tejzgjatur, e kanë njoftuar gjykatën e rregullt përmes një parashtrese që gjendja ka ndryshuar ngase kanë vdekur edhe një pjesë e trashëgimtarëve të trashëgimlënëses.

48. Parashtruesi i kërkesës pretendon se procedura e zhvilluar në gjykatë të rregullt i ka mohuar mundësinë për një vendim të shpejtë dhe të drejtë. Më konkretisht, parashtruesi i kërkesës thekson se *"Edhe pse kërkuesi ka bërë kërkesa urgjente për caktimin e seancës gjyqësore, ato nuk janë marrë parasysh dhe nuk ka pasur veprime konkrete nga gjykata. Kjo tregon një mungesë të efikasitetit dhe të drejtësisë, duke mos siguruar një trajtim të duhur të çështjes. Një gjykim i drejtë dhe i paanshëm përfshin që çdo palë të ketë mundësinë të paraqesë rastin e saj dhe të marrë një vendim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm. Mungesa e një seance gjyqësore të caktuar është një tjetër element që e cenon këtë të drejtë"*.

49. Parashtruesi i kërkesës thekson se mosveprimi i gjykatave për mbi dy dekada përbën shkelje të së drejtës të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, duke theksuar se të gjitha palët kanë të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një periudhe të arsyeshme dhe përpara një gjykate të pavarur dhe të paanshme, aspekt ky thelbësor për të siguruar që proceset gjyqësore të mos jenë të zgjatura dhe të krijojnë mundësi për keqpërdorime.

50. Në fund, parashtruesi i kërkesës thekson se, aktualisht lënda në fjalë gjendet në Gjykatën Themelore dhe ka numër të SMIL: 2023:173691 dhe ende nuk është shqyrtuar tutje, si dhe potencon se andaj *"në emër të kompensimit dëmit jomaterial – dhembjeve shpirtrore për shkelje të drejtës në gjykim në një proces të drejtë, neni 6, i KEDNJ dhe nenit 31 e drejta për gjykim të drejtë dhe të pa anëshëm kërkoj shumën prej 10,000.00 euro"*.

Përgjigjet e Gjykatës Themelore në Gjakovë në pyetjet e parashtruara nga Gjykata më 28 prill 2025

51. Më 28 prill 2025, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore që të përgjigjet në pyetjet sikurse në vijim:

> *"(i) Më 1 shkurt 2002, Gjykata Komunale në Gjakovë, përmes Aktvendimit [T.nr.29/2000], ka ndërprerë procedurën në çështjen juridike deri në përfundimin e lëndës [Civ.nr.279/97] dhe [C.nr.314/2001], ku janë të përfshira të njëjtat paluajtshmëri si në propozimin për zbatimin e procedurës trashëgimore.*
> *(ii) Përkitazi me Aktvendimin në fjalë, luteni të njoftoni Gjykatën kur ka filluar ndërprerja e procedurës dhe nëse ka përfunduar – kur ka përfunduar ndërprerja e procedurës së trashëgimisë?*
> *(iii) A ekzistojnë akoma rrethana të cilat në bazë të ligjit të aplikueshëm kërkojnë ndërprerjen e procedurës së çështjes juridike në fjalë?*
> *(iv) A mund të na njoftoni se në cilën fazë të procedurës është aktualisht çështja (CT.nr.29/2000) pranë Gjykatës Themelore në Gjakovë?"*

52. Më 14 maj 2025, Gjykata Themelore dorëzoi në Gjykatë përgjigjet lidhur me pyetjet e lartcekura. Gjykata Themelore përmes shkresës theksoi se procedura në lëndën jokontestimore [T.nr.29/2000], e paraqitur në Gjykatën Komunale nga trashëgimtarët e radhës së parë të trashëgimlënëses [N.SH], për shqyrtimin e trashëgimisë është

ndërprerë më 1 shkurt 2002 deri në përfundim të lëndëve [Civ.nr.279/97] dhe [C.nr.314/2001], pasi janë të përfshira të njëjtat paluajtshmëri si në propozim për zbatim të procedurës së trashëgimisë.

53. Përkitazi me lëndën kontestimore [C.nr.297/97], Gjykata Themelore në Gjakovë specifikoi se *"në lëndën me shenjën C.nr.279/97 e datës 21.12.2001, është bërë përtëritja e shkresave të lëndës Civ.nr.279/97, si dhe përmes shkresës së datës 22.09.2008 lënda është arkivuar dhe e njëjta është pjesë e shkresave të lëndës T.nr.29/2000".*

54. Ndërkaq, lidhur me lëndën [C.nr. 314/01], Gjykata Themelore sqaroi se kjo lëndë është e arkivuar. Në përgjigjen e dhënë nga Gjykata Themelore u theksua se paraprakisht në këtë lëndë, më 11 dhjetor 2009, procedura ishte ndërprerë me kërkesë të paditësit derisa Gjykata Kushtetuese të vendoste përkitazi me kërkesën KI52/09 për vlerësim të kushtetueshmërisë të ushtruar në Gjykata Kushtetuese, e cila çështje konsiderohej paraprake për vendosjen meritore të kontestit lëndor. Gjykata Themelore specifikoi se pas shqyrtimit të kërkesës nga Gjykata Kushtetuese dhe parashtrimit të kërkesës për vazhdim të procedurës së ndërprerë, procedura ka vazhduar duke marrë numër të ri të lëndës dhe atë [C.nr.145/12].

55. Lidhur me këtë lëndë, Gjykata Themelore përmes përgjigjes së saj theksoi se, procedura është ndërprerë sërish përmes Aktvendimit [C.nr.145/12] të 30 dhjetorit 2012, për shkak të vdekjes së të paditurit [A.SH] dhe lënda vazhdon të jetë e arkivuar si lëndë e ndërprerë. Në këtë drejtim, Gjykata Themelore theksoi se "*Rrjedhimisht, lënda C.nr. 314/2001, për shkak të së cilës është ndërprerë procedura jo kontestimore nuk ka përfunduar ende me asnjë vendim meritor. Ndërsa i autorizuari i trashëgimtarit Adem Shehu, ende pa përfunduar çështja kontestimore me numër C.nr. 314/2000 (145/12), përmes parashtresës së datës 08.04.2025, ka kërkuar nga gjykata që me urgjencë të caktojë seancën në çështjen trashëgimore me numër CT.nr.29/2000, kërkesë e cila do të shqyrtohet nga gjykata në afat sa më të shpejt kohor".*

56. Në mbështetje të përgjigjeve të parashtruara në Gjykatë, Gjykata Themelore dorëzoi në Gjykatë edhe (ii) procesverbalin e seancës së mbajtur më 11 dhjetor 2009 në Gjykatën Komunale në çështjen kontestimore [C.nr. 314/01] për vërtetimin e pronësisë, përmes të cilit ishte propozuar që të ndërpritet procedura deri në vendimin e Gjykatës Kushtetuese përkitazi me kërkesën e referuar, propozim që ishte aprovuar; si dhe (ii) Aktvendimin e 30 tetorit 2012 lidhur me ndërprerjen e procedurës në çështjen kontestimore për vërtetimin e pronësisë në lëndën [C.nr.145/12].

Përgjigjet e Gjykatës Themelore në Gjakovë në pyetjet e parashtruara nga Gjykata më 29 korrik 2025

57. Më 29 korrik 2025, Gjykata, me qëllim që të ketë një pasqyrë të plotë të rastit, kërkoi nga Gjykata Themelore që të përgjigjet në pyetjet përkitazi me kronologjinë dhe statusin aktual të lëndëve në procedurë kontestimore për shkak të të cilave është ndërprerë procedura në lëndën e trashëgimisë, dhe atë si në vijim:

> ***"Lidhur me lëndën jokontestimore [CT.nr.29/2000], procedurë e trashëgimisë në të cilën parashtruesi i kërkesës pretendon tejzgjatje të procedurës para Gjykatës Kushtetuese:***
>
> *(I) Kërkohet nga ana Juaj të na ofroni informata rreth historikut, fakteve dhe kronologjisë së trajtimit të këtij rasti.*
> *(ii) Në bazë të përgjigjes tuaj të datës 14 maj 2025, rezulton se në këtë lëndë procedura është ndërprerë, luteni të sqaroni se cili është statusi aktual i lëndës.*

(iii) Nëse rezulton se lënda akoma është e ndërprerë, cilat janë pengesat ligjore për zhvillimin e procedurës në këtë lëndë?
(iv) Njëheri në përgjigjen tuaj specifikohet se kjo procedurë është ndërprerë deri në përfundimin e lëndëve [C.nr.297/97] dhe [C.nr. 314/01], ku janë të përfshira të njëjtat paluajtshmëri sikurse në propozimin për zbatim të procedurës së trashëgimisë. Përkitazi me dy lëndët e sipërpërmendura, pyetje të veçanta janë të parashtruara më poshtë nga ana e Gjykatës. Përjashtimisht, këtyre dy lëndëve të specifikuara, a ekziston edhe ndonjë lëndë tjetër në procedurë kontestimore që ndërlidhet me paluajtshmëritë që janë pjesë e masës trashëgimore?

Lidhur me lëndën kontestimore [C.nr.297/97] - në të cilën ishte e përfshirë e njëjta paluajtshmëri si në propozimin për zbatim të procedurës së trashëgimisë në lëndën jokontestimore [CT.nr.29/2000]:

(i) Cili është objekti i shqyrtimit në lëndën [C.nr.297/97]? Kërkohet nga ana Juaj të na ofroni informata rreth historikut, fakteve dhe kronologjisë së trajtimit të këtij rasti.
(ii) Cili është statusi aktual i kësaj lënde? A është lëndë që akoma është në procedurë apo është lëndë e cila ka përfunduar me vendim të formës së prerë?
(iii) Në përgjigjen tuaj të 14 majit specifikohet se është bërë përtëritja e shkresave të kësaj lënde, luteni të na sqaroni se pse është ndërmarrë ky hap procedural?
(iv) Njëheri potencohet se lënda është e arkivuar dhe e njëjta është pjesë e shkresave të lëndës [CT.nr.29/2000], luteni të sqaroni se pse është arkivuar kjo lëndë?
(v) Po ashtu, na jepni përgjigje nëse janë të sakta pretendimet e parashtruesit që kjo lëndë ka përfunduar me vendim të formës së prerë.

Lidhur me lëndën kontestimore [C.nr. 314/01], e cila më pas ka marrë numrin [C.nr.145/12] - në të cilën ishte e përfshirë e njëjta paluajtshmëri si në propozimin për zbatim të procedurës së trashëgimisë në lëndën jokontestimore [CT.nr.29/2000]:

(i) Cili është objekti i shqyrtimit në lëndën [C.nr.314/01]? Kërkohet nga ana Juaj të na ofroni informata rreth historikut, fakteve dhe kronologjisë së trajtimit të këtij rasti, si dhe informatat e sakta lidhur me lëndën e kontestit?
(ii) Po ashtu, na jepni përgjigje nëse janë të sakta pretendimet e parashtruesit që lënda e kontekstit në këtë rast është pengimi i posedimit? Nëse përgjigja është pohore, gjegjësisht PO, na e shpjegoni se pse kontesti në lidhje me pengimin e posedimit do të ishte pengesë e zhvillimit të procedurës trashëgimore?
(iii) Në përgjigjen tuaj të 14 majit specifikohet se lënda ka marrë numër të ri dhe atë [C.nr.145/12], luteni të na sqaroni se pse është ndërmarrë ky hap procedural?
(iv) Po ashtu, në përgjigjen tuaj është theksuar se kjo lëndë përmes Aktvendimit [C.nr.145/12] të 30 dhjetorit 2012 është ndërprerë për shkak të vdekjes së të paditurit [A.SH] dhe lënda vazhdon të jetë e arkivuar si lëndë e ndërprerë - (i) Cili është statusi aktual i kësaj lënde?; (ii) A është ndërmarrë ndonjë hap procedural tutje në lëndën në fjalë, qoftë nga ana e Gjykatës Themelore sipas detyrës zyrtare apo nga trashëgimtarët e [A.SH]?; (iii) Nëse po, cilët janë hapat e ndërmarrë?; si dhe (iv) Nëse jo, luteni të sqaroni se cilat janë pengesat për procedimin e lëndës në fjalë?"

58. Më 26 gusht 2025, Gjykata Themelore dorëzoi përgjigjet në Gjykatë dhe përkitazi me lëndën [T.nr.29/2000] theksoi se më 1 shkurt 2002 ka ndërprerë procedurën jokontestimore deri në përfundimin e lëndëve [Civ.nr.279/97] dhe [C.nr.314/2001], ku janë të përfshira të njëjtat paluajtshmëri si në propozim për zbatim të procedurës së

trashëgimisë. Ndaj këtij Aktvendimi është parashtruar ankesë në Gjykatën e Qarkut në Pejë nga ana e trashëgimtarëve të [N.SH], porse e njëjta është refuzuar, duke lënë në fuqi Aktvendimin për ndërprerje të procedurës. Sipas përgjigjes së Gjykatës Themelore, gjyqtarja që më herët kishte shqyrtuar lëndën, më 26 gusht 2009 ka pranuar shkresat e lëndës [T.nr.29/2000], e cila lëndë me rastin e dorëzimit ka marrë numër të ri [T.nr.125/2009]. Tutje, Gjykata Themelore thekson se më 19 tetor 2009, gjyqtarja e çështjes i është drejtuar shkrimores së Gjykatës Komunale që për nevoja të lëndës t'ia dorëzojë shkresat e lëndës [C.nr.279/97]. Në fund të përgjigjes përkitazi me këtë lëndë, specifikohet se i autorizuari i trashëgimtarit Adem Shehu ka kërkuar më 8 prill 2005 që me urgjencë të caktohet seanca në çështjen trashëgimore, porse lidhur me këtë kërkesë nuk është vendosur, duke qenë se lëndët për të cilat është ndërprerë procedura nuk rezultojnë të kenë përfunduar me vendim të formës së prerë.

59. Sa i përket lëndës [C.nr.279/97], Gjykata Themelore theksoi se nga shkresat e lëndës rezulton se nga paditësja [N.SH] është parashtruar kërkesë me datën 12 dhjetor 2000 për rekonstruimin e shkresave të lëndës, me arsyetimin se shkresat e lëndës kanë mbetur në Serbi, kjo pasi që lidhur me këtë çështje është parashtruar revizion në Gjykatën Supreme të Beogradit ndaj vendimit të Gjykatës së Qarkut të Pejës, e cila kishte refuzuar ankesën e paditëses kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Gjakovë. Më 21 dhjetor 2001, Gjykata Komunale, përmes Aktvendimit [Civ.nr.279/97], ka bërë ripërtëritjen e shkresave të lëndës. Kundër këtij Aktvendimi është paraqitur ankesë, e cila përmes Aktvendimit [AC.nr.40/2002] të Gjykatës së Qarkut në Pejë, është refuzuar si e pabazuar. Ndërkaq, më 22 shkurt 2008, gjyqtari i çështjes përmes një shkrese i është drejtuar shkrimores në Gjykatën Komunale që të arkivohet lënda, pasi është përfunduar procedura sipas kërkesës për rekonstruimin e shkresave të lëndës.

60. Përkitazi me lëndën [C.nr. 314/2001], Gjykata Themelore specifikoi se objekt të çështjes ka padinë për vërtetim të së drejtës së pronësisë, të paraqitur më 27 korrik 2001, nga paditësi [A.SH] kundër të padituve: [A.SH],[H.SH], [F.SH] dhe Adem Shehu. Më 11 dhjetor 2009, është marrë Aktvendim për ndërprerje të procedurës derisa Gjykata Kushtetuese të vendosë lidhur me kërkesën për vlerësim të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë në rastin KI52/09, e cila është konsideruar si çështje paraprake për vendosje meritore të kontestit lëndor. Më pas, në këtë çështje është parashtruar kërkesa e datës 24 prill 2012 për vazhdimin e procedurës së ndërprerë dhe procedura ka vazhduar, me ç'rast, lënda ka marrë numër të ri [C.nr.145/12], mirëpo është ndërprerë përsëri për shkak të vdekjes së padituri [A.SH] dhe nuk është vazhduar më. Në këtë çështje, sipas përgjigjes së Gjykatës Themelore, lënda vazhdon të jetë e arkivuar, ndërsa nga shkresat e lëndës rezulton se nuk ka asnjë kërkesë për vazhdim të procedurës së ndërprerë apo ndërmarrë ndonjë veprim për vazhdim të së njëjtës. Rrjedhimisht, kjo lëndë nuk ka përfunduar ende me ndonjë vendim meritor.

61. Lidhur me dy lëndët e sipërtrajtuara, Gjykata Themelore potencoi se *"[...] duke qenë se nga kërkesa për vazhdim të procedurës nuk është provuar fakti se lëndët për të cilat është ndërprerë procedura të kenë përfunduar me vendim të formës së prerë nga Gjykatat e Republikës së Kosovës, përkatësisht lëneda me nnumër C.nr.279/97, si lëndë e ripërtërirë ka një vendim të Gjykatës Supreme të Beogradit-Serbi Rev.nr.995/99, të datës 02.02.2000 dhe lënda me numër C.nr.314/2011 (145/12) është lëndë e ndërprerë për shkak të vdekjes së të padituri"*.

62. Gjykata Themelore theksoi se ka gjetur se ekziston edhe një lëndë kontestimore me numër [C.nr.93/20], me paditëse [M.SH], e cila më 29 janar 2020 ka paraqitur padi për vërtetim të së drejtës së pronësisë në paluajtshmërinë e cila evidentohet në emër të [N.SH], si trashëgimlënëse e parashtruesit të kërkesës. Përmes Aktvendimit të datës 2 maj 2025, në këtë lëndë është ndërprerë procedura deri në vendosjen e formës së prerë të lëndës [T.nr.29/2000].

DISPOZITAT RELEVANTE KUSHTETUESE DHE LIGJORE

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

"1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
[...]"

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 6
(E drejta për një proces të rregullt)

1. "Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
[...].

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

63. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

64. Në këtë drejtim, Gjykata u referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcakton:

Nenit 113
[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

65. Gjykata gjithashtu u referohet kritereve të pranueshmërisë, siç janë të parashikuara me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata u referohet neneve 47 (Kërkesa Individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, që parashohin:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Neni 49
(Afatet)

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor[...]".

66. Sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar në kuptim të paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe se parashtruesi i kërkesës ka saktësuar kërkesën e tij ashtu siç kërkohet me nenin 48 të Ligjit. Në lidhje me afatshmërinë e kërkesës, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës konteston tejzgjatjen e procedurës përkitazi me lëndën [T.nr.29/2000] në Gjykatën Themelore në Gjakovë. Gjykata, duke pasur parasysh natyrën e pretendimit, gjegjësisht tejzgjatjen e procedurës pranë kësaj instance gjyqësore, rikujton se në rrethana të tilla nuk kërkohet përmbushja e kriterit të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit, përkatësisht kriteri për dorëzimin e kërkesës brenda afatit kohor prej 4 (katër) muajve.

67. Gjykata gjithashtu thekson se kërkesa nuk është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të rregullit 34 të Rregullores së punës, prandaj ajo duhet deklaruar e pranueshme dhe duhet të shqyrtohen meritat e saj.

Meritat

68. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës, më 7 nëntor 2000, kishte dorëzuar kërkesën për zbatimin e procedurës së trashëgimisë të lënë pas nga nëna e tij në Gjykatën Komunale në Gjakovë. Më 1 shkurt 2002, Gjykata Komunale, përmes Aktvendimit [T.nr.29/2000], e ndërpreu çështjen juridike lidhur me procedurën e trashëgimisë deri në përfundimin e procedurave në lëndët [Civ.nr.279/97] dhe [Civ.nr.314/2001], që ndërlidhen me ngastrat kadastrale të specifikuara në propozimin e parashtruesit të kërkesës për zbatimin e procedurës trashëgimore. Më 9 shkurt 2002, parashtruesi i

kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Qarkut kundër Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Komunale, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës civile, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Përmes kësaj ankese, parashtruesi i kërkesës pretendoi se lënda [Civ.nr.279/97] ka përfunduar me vendim të formës së prerë, ndërkaq lidhur me lëndën [C.nr.314/01], potencoi se fakti se trashëgimtari [A.SH] ka paraqitur padi nuk paraqet bazë për ndërprerje të procedurës. Përmes Aktvendimit [Ac.81/2002], Gjykata e Qarkut në Pejë e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruar dhe e vërtetoi Aktvendimin e lartpërmendur të Gjykatës Komunale.

69. Gjykata rikujton se përkitazi me dy lëndët kontestimore, si pasojë e zhvillimit të të cilave është ndërprerë procedura në procedurën jokontestimore për ndarjen e trashëgimisë, nga shkresat e lëndës rezulton se, sa i përket lëndës [C.nr.279/97], e njëjta është iniciuar për anulimin e kontratës për dhurimin e pasurisë së paluajtshme dhe, më 9 korrik 1997, Gjykata Komunale e anuloi kontratën [Ov.nr. 237/96] e 1 marsit 1996 për dhurimin e pasurisë së paluajtshme, e lidhur mes [N.SH], në cilësinë e dhurueses dhe [A.SH], në cilësinë e marrësit të dhuratës. Në një datë të paspecifikuar, [A.SH] paraqiti ankesë në Gjykatën e Qarkut në Pejë kundër Aktgjykimit të 9 korrikut 1997 të Gjykatës Komunale. Më 7 tetor 1998, Gjykata e Qarkut në Pejë përmes Aktgjykimit [Gzh.nr.480/98], e refuzoi si të pabazuar ankesën e [A.SH] dhe e vërtetoi Aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Komunale. Në këtë rast, nga paditësja [N.SH] është parashtruar kërkesë me datën 12 dhjetor 2000 për rekonstruimin e shkresave të lëndës, me arsyetimin se shkresat e lëndës kanë mbetur në Serbi, kjo pasi që lidhur me këtë çështje është parashtruar revizion në Gjykatën Supreme të Beogradit ndaj vendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, e cila kishte refuzuar ankesën e paditëses kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Gjakovë. Më 21 dhjetor 2001, Gjykata Komunale, përmes Aktvendimit [Civ.nr.279/97], ka bërë ripërtëritjen e shkresave të lëndës. Kundër këtij Aktvendimi, është paraqitur ankesë, e cila përmes Aktvendimit [AC.nr.40/2002] të Gjykatës së Qarkut në Pejë, është refuzuar si e pabazuar. Ndërkaq, më 22 shkurt 2008, gjyqtari i çështjes përmes një shkrese i është drejtuar shkrimores në Gjykatën Komunale që të arkivohet lënda, pasi është përfunduar procedura sipas kërkesës për rekonstruimin e shkresave të lëndës.

70. Gjykata vë në dukje se, përkitazi me lëndën [C.nr. 314/2001], rezulton se objekt të çështjes ka padinë për vërtetim të së drejtës së pronësisë, e paraqitur me 27 korrik 2001 nga paditësi [A.SH] kundër të padituve: [A.SH.], [H.SH.], [F.SH.] dhe Adem Shehu. Më 11 dhjetor 2009 është marrë Aktvendim për ndërprerjen e procedurës derisa Gjykata Kushtetuese të vendosë lidhur me kërkesën për vlerësim të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë në rastin KI52/09, e cila është konsideruar si çështje paraprake për vendosje meritore të kontestit lëndor. Më pas, në këtë çështje është parashtruar kërkesa e datës 24 prill 2012 për vazhdimin e procedurës së ndërprerë dhe procedura ka vazhduar, me ç'rast, lënda ka marrë numër të ri [C.nr.145/12], mirëpo është ndërprerë përsëri, për shkak të vdekjes së të paditurit [A.SH] dhe nuk është vazhduar më. Në këtë çështje, lënda vazhdon të jetë e arkivuar, ndërsa nga shkresat e lëndës rezulton se nuk ka asnjë kërkesë për vazhdim të procedurës së ndërprerë apo të jetë ndërmarrë ndonjë veprim për vazhdim të së njëjtës. Rrjedhimisht, kjo lëndë nuk ka përfunduar ende me ndonjë vendim meritor.

71. Po ashtu, Gjykata sjell në vëmendje se, nga shkresat e lëndës rezulton se ekziston edhe një lëndë kontestimore me numër [C.nr.93/20], me paditëse [M.SH], e cila më 29 janar 2020 ka paraqitur padi për vërtetim të së drejtës së pronësisë në paluajtshmërinë e cila evidentohet në emër të [N.SH], si trashëgimlënëse e parashtruesit të kërkesës. Përmes Aktvendimit të datës 2 maj 2025, në këtë lëndë është ndërprerë procedura deri në vendosjen e formës së prerë të lëndës [T.nr.29/2000].

72. Në kërkesën e tij para Gjykatës, parashtruesi i kërkesës specifikon se i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si rezultat i kohëzgjatjes së procedurës përkitazi me procedurën për zbatimin e trashëgimisë në lëndën [T.nr.29/2000].

73. Gjykata në vijim do të shqyrtojë pretendimin e parashtruesit për tejzgjatje të procedurës së zhvilluar dhe do ta trajtojë nga këndvështrimi i të drejtave të garantuara përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, duke aplikuar edhe parimet dhe kriteret e vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në të cilin rast Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

Përkitazi me pretendimin lidhur me kohëzgjatjen e procedurës gjyqësore

Përcaktimi i kohëzgjatjes së procedurës

74. Gjykata rikujton se, bazuar në praktikën e GJEDNJ-së, përllogaritja e kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore fillon nga momenti kur gjykata kompetente vihet në lëvizje me kërkesë të palës për vendosjen e një të drejte apo interesi legjitim të pretenduar (shih rastin e GJEDNJ-së: *Poiss kundër Austrisë*, nr. 9816/82, Aktgjykim i 23 prillit 1987, paragrafi 50).

75. Në përllogaritjen e kohëzgjatjes së procedurës merret për bazë e gjithë procedura në tërësi, përfshirë këtu edhe procedurat e apelimit (shih rastin e GJEDNJ-së: *Konig kundër Gjermanisë*, nr. 6232/73, Aktgjykim i 28 qershorit 1978, paragrafi 98). Procesi gjyqësor konsiderohet i përfunduar në momentin e nxjerrjes së vendimit përfundimtar nga instanca e fundit gjyqësore (shih rastet e GJEDNJ-së: *Eckle kundër Republikës Federale të Gjermanisë*, nr. 8130/78, Aktgjykim i 15 korrikut 1982, paragrafi 74; dhe *Poiss kundër Austrisë*, cituar më lart, paragrafi 50).

76. Ekzekutimi i një vendimi gjyqësor konsiderohet pjesë integrale e gjithë procedurës dhe përfshihet në përllogaritjen e kohës së zgjatjes së asaj procedure (shih rastin e GJEDNJ-së: *Martins Moreira kundër Portugalisë*, nr. 11371/85, Aktgjykim i 26 tetorit 1988, paragrafi 44). Përllogaritja e kohëzgjatjes së procedurës nuk ndërpritet deri në momentin kur e drejta e fituar bëhet efektive (shih rastin e GJEDNJ-së: *Estima Jorge kundër Portugalisë*, nr. 24550/94, Aktgjykim i 21 prillit 1998, paragrafët 36-38).

A. Parimet e përgjithshme të kohëzgjatjes së procedurës

77. Gjykata rikujton se, është detyrim i shtetit që të organizojë sistemin e drejtësisë në mënyrë të tillë që gjykatat të mund të garantojnë të drejtat e secilit për një vendim përfundimtar gjyqësor në lidhje me të drejtat dhe obligimet civile të tyre brenda një afati të arsyeshëm kohor (shih rastet e GJEDNJ-së: *Comingersoll kundër Portugalisë*, nr. 35382/97, Aktgjykim i 6 prillit 2000, paragrafi 24; *Famullia Katolike Greke e Lupenit dhe të tjerët kundër Rumanisë*, nr. 76943/11, Aktgjykim i 29 nëntorit 2016, paragrafi 142).

78. Gjykata rikujton se administrimi i drejtësisë pa vonesa është shumë i rëndësishëm për të mos e rrezikuar efikasitetin dhe kredibilitetin e sistemit të drejtësisë (shih rastin e GJEDNJ-së: *Scordino kundër Italisë* (nr.1), nr. 36813, Aktgjykim i 29 marsit 2006, paragrafët 224-225). Zgjatja e tepruar e administrimit të drejtësisë përbën një nga rreziqet kryesore kundër sundimit të ligjit. Kur shkeljet në lidhje me zgjatjen e procedurave gjyqësore bëhen të shpeshta dhe nuk janë raste të izoluara, atëherë

akumulimi i këtyre shkeljeve përbën një praktikë e cila nuk është në përputhje me KEDNJ-në (shih rastin e GJEDNJ-së: *Bottazzi kundër Italisë*, nr. 34884/97, Aktgjykim i 28 korrikut 1999, paragrafi 22).

79. Arsyeshmëria e zgjatjes së një procesi gjyqësor duhet të vlerësohet duke u bazuar në rrethanat përkatëse të secilit rast (shih rastin e GJEDNJ-së: *Frydlender kundër Francës*, nr. 30979/96, Aktgjykim i 27 qershorit 2000, paragrafi 43). Vlerësimi për arsyeshmërinë e zgjatjes së procedurave gjyqësore duhet të bëhet mbi bazën e karakteristikave të një rasti: për shembull, në çështjen e ndarjes së trashëgimisë ndërmjet pasardhësve të një personi të vdekur, që zgjati më shumë se 22 vjet (shih rastin e GJEDNJ-së: *Omdahl kundër Norvegjisë*, nr. 46371/18, Aktgjykim i 6 shtatorit 2021, paragrafët 471, 54-55). Arsyeshmëria e zgjatjes së procedurës gjyqësore matet duke u bazuar në këto kritere kryesore: kompleksiteti i rastit, sjellja e palës, sjellja e autoriteteve shtetërore dhe rëndësia e asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontestin gjyqësor (shih rastet e GJEDNJ-së: *Sürmeli kundër Gjermanisë*, nr. 75529/01, Aktgjykim i 8 qershorit 2006, paragrafi 128; dhe *Nicolae Virgiliu Tanase kundër Rumanisë*, nr. 41720/13, Aktgjykim i 25 qershorit 2019, paragrafi 209).

Kriteret e vlerësimit të arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës

Kompleksiteti i rastit

80. Sipas praktikës së GJEDNJ-së, kompleksiteti i rastit mund të ndërlidhet me çështjet faktike dhe ligjore; me përfshirjen e disa palëve në procedurë; me një numër të caktuar provash që duhet trajtuar para gjykatave të rregullta; apo edhe me një numër më të madh të raporteve të ekspertëve që kërkohen (shih rastet e GJEDNJ-së: *Papachelas kundër Greqisë*, nr. 31423/96, Aktgjykim i 25 marsit 1999; *Katte Klitsche de la Grange kundër Italisë*, nr. 12539/86, Aktgjykim i 27 tetorit 1994, paragrafi 55; *H. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 9580/81, Aktgjykim i 8 korrikut 1987, paragrafi 72; *Humen kundër Polonisë*, nr. 26614/95, Aktgjykim i 15 tetorit 1999, paragrafi 63; dhe *Nicolae Virgiliu Tanase kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 210).

81. Edhe në rastet kur një procedurë nuk është komplekse, mungesa e qartësisë dhe parashikueshmërisë në legjislacionin vendas mund të vështirësojë zgjidhjen e rastit dhe të kontribuojë në kohëzgjatjen e procedurës (shih rastin e GJEDNJ-së: *Famullia Katolike Greke e Lupenit dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 150).

Sjellja e palës

82. Sipas GJEDNJ-së, neni 6 i KEDNJ-se nuk kërkon nga pala bashkëpunim aktiv me autoritetet gjyqësore, e as nuk mund të fajësohet për përdorimin e mjeteve juridike sipas legjislacionit në fuqi. Megjithatë, autoritetet shtetërore nuk mund të mbahen përgjegjëse nëse këto veprime ndikojnë në kohëzgjatjen e procedurës (shih rastet e GJEDNJ-së: *Erkner dhe Hofauer kundër Austrisë*, nr. 9616/81, Aktgjykim i 23 prillit 1987, paragrafi 68; dhe *Nicolae Virgiliu Tanase kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 211).

83. Nga pala kërkohet vetëm të jetë e vëmendshme në ndërmarrjen e hapave proceduralë dhe të mos përdorë taktika për ta shtyrë në favor të tij procedurën (shih rastin e GJEDNJ-së: *Union Alemntaria Sanders S.A kundër Spanjës*, nr. 11681/85, Aktgjykim i 7 korrikut 1989, paragrafi 35). Sjellja e palës përbën një fakt objektiv që nuk mund t'i mëvishet autoriteteve shtetërore, dhe duhet të merret parasysh gjatë vlerësimit nëse procedura ishte kryer brenda një periudhe të arsyeshme kohore (shih rastin e GJEDNJ-së: *Wiesinger kundër Austrisë*, nr. 11796/85, Aktgjykim i 30 tetorit 1991, paragrafi 57). Vetëm vonesat që i atribuohen shtetit mund të ndikojnë në përcaktimin nëse procedurat

nuk kishin përfunduar brenda një afati të arsyeshëm kohor (shih rastin e GJEDNJ-së: *Humen kundër Polonisë*, cituar më lart, paragrafi 66).

84. Disa shembuj që kanë të bëjnë me sjelljen e palës: mungesa e vullnetit të palës për të dorëzuar shkresat mund të ndikojë në ngadalësimin e procedurës; ndryshimi i shpeshtë i avokatit; përpjekjet për të arritur marrëveshje jashtëgjyqësore; nisja e procedurës para gjykatës që nuk ka juridiksion për çështjen; mungesa e kujdesit në ndërmarrjen e hapave proceduralë (shih rastet e GJEDNJ-së: *Vernillo kundër Francës*, nr. 11889/85, Aktgjykim i 20 shkurtit 1991, paragrafi 34; *Konig kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 103; *Pizzetti kundër Italisë*, nr. 12444/86, Aktgjykim i 26 shkurtit 1993, paragrafi 18; *Beaumartin kundër Francës*, nr. 15287/89, Aktgjykim i 24 nëntorit 1994, paragrafi 33; dhe *Keaney kundër Irlandës*, nr. 72060/17, Aktgjykim i 30 prillit 2020, paragrafi 95).

Sjellja e autoriteteve shtetërore

85. Shteti mban përgjegjësi për të gjitha autoritetet: jo vetëm për sistemin gjyqësor, por për të gjitha institucionet publike (shih rastin e GJEDNJ-së: *Martins Moreira kundër Portugalisë*, cituar më lart, paragrafi 60). Gjatë vlerësimit nëse procedura është kryer brenda një afati të arsyeshëm kohor, Gjykata duhet të vlerësojë procedurën në tërësi: përkundër që shteti mund të jetë përgjegjës për defekte të caktuara procedurale, megjithatë, kjo nuk e përjashton mundësinë që të ketë vepruar në përputhje me detyrat e veta për ta shqyrtuar rastin në mënyrë të shpejtë (shih rastin e GJEDNJ-së: *Nicolae Virgiliu Tanase kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 211).

86. Shkaktimi i vonesave nga ndërrimi i shpeshtë i gjyqtarëve nuk e shmang përgjegjësinë e shtetit për kryerjen e procedurave brenda afateve të arsyeshme kohore, sepse është detyrë e shtetit që ta organizojë sistemin e drejtësisë në mënyrë të përshtatshme (shih rastin e GJEDNJ-së: *Lechner dhe Hess kundër Austrisë*, nr. 9316/81, Aktgjykim i 23 prillit 1987, paragrafi 58). Mbingarkesa kronike e lëndëve nuk mund të shërbejë si arsyetim për tejzgjatjen e procedurave (shih rastin e GJEDNJ-së: *Probstmeier kundër Gjermanisë*, nr. 20950/92, Aktgjykim i 1 korrikut 1997, paragrafi 64). Vonesat e shkaktuara nga reformat që synojnë të përshpejtojnë zgjidhjen e rasteve nuk mund po ashtu të shërbejnë si arsyetim për tejzgjatje të procedurës, për shkak se është përgjegjësi dhe detyrë e shtetit ta organizojë sistemin e drejtësisë në mënyrë që të shmangë tejzgjatjen e procedurave në rastet e mbetura pa u zgjidhur (shih rastin e GJEDNJ-së: *Fisanotti kundër Italisë*, nr. 32305/96, Aktgjykim i 23 prillit 1998, paragrafi 22).

87. Gjykata, në praktikën e saj gjyqësore, ka theksuar se gjykatat e rregullta duhet të kenë parasysh obligimin kushtetues dhe ligjor që çështjet t'i finalizojnë brenda një afati të arsyeshëm, në mënyrë që vonesat e tejzgjatura të mos shkaktojnë pasiguri te palët. Gjykatat nuk mund të lejojnë që rasti të bartet pafundësisht prej një instance gjyqësore te tjetra. Në të kundërtën, besimi i publikut ndaj rendit juridik do të rrezikohej (shih rastin e Gjykatës: KI06/21, parashtrues *Dragan Mihajlović*, Aktgjykim i 22 dhjetorit 2022, paragrafi 67).

Rëndësia e asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontest

88. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ekzistojnë kategori të caktuara të rasteve të cilat për nga natyra e tyre duhet të trajtohen me kujdes të veçantë dhe të vendosen me shpejtësi më të madhe. Shembuj të këtyre kategorive të rasteve përfshijnë:
    a) Rastet që ndërlidhen me statusin civil (çështja e divorcit, vërtetimi i atësisë) (shih rastet e GJEDNJ-së: *Bock kundër Gjermanisë*, nr. 11118/84, Aktgjykim i 29 marsit

1989, paragrafi 49; dhe *Mikulić kundër Kroacisë*, nr. 53176/99, Aktgjykim i 7 shkurtit 2002, paragrafi 44).

b) Rastet që ndërlidhen me kujdestarinë e fëmijëve; me raportin prind-fëmijë; me kujdesin e gjyshërve ndaj fëmijëve, kur këta të fundit kanë mbetur pa kujdesin e prindërve; përgjegjësinë e prindërve dhe të drejtat e kontaktit me fëmijët (shih rastet e GJEDNJ-së: *Hokkanen kundër Finlandës*, nr. 19823/92, Aktgjykim i 23 shtatorit 1994, paragrafi 72; *Tsikakis kundër Gjermanisë*, nr. 1521/06, Aktgjykim i 10 shkurtit 2011, paragrafët 64-68; *Paulsen-Medalen dhe Svensson kundër Suedisë*, nr. 16817/90, Aktgjykim i 19 shkurtit 1998, paragrafi 39*; Q dhe R kundër Sllovenisë*, nr. 19938/20, Aktgjykim i 8 shkurtit 2022, paragrafi 80).

c) Rastet që ndërlidhen me kontestet nga marrëdhënia e punës; ankesa kundër largimit nga puna; suspendimi nga puna; transferimi; rikthimi në punë; çështjet që lidhen me pensionin (shih rastet e GJEDNJ-së: *Frydlender kundër Francës*, cituar më lart, paragrafi 45; *Vocaturo kundër Italisë*, nr. 11891/85, Aktgjykim i 24 majit 1991, paragrafi 17; *Obermeier kundër Austrisë*, nr. 11761/85, Aktgjykim i 28 qershorit 1990, paragrafi 72; *Sartory kundër Francës*, nr. 40589/07, Aktgjykim i 24 shtatorit 2009, paragrafi 34; *Ruotolo kundër Italisë*, nr. 12460/86, Aktgjykim i 27 shkurtit 1992, paragrafi 117; *Borgese kundër Italisë*, nr. 12870/87, Aktgjykim i 26 shkurtit 1992, paragrafi 18).

d) Rastet që ndërlidhen me persona të cilët vuajnë nga "sëmundje të pashërueshme" dhe kanë "pritje të reduktuar të jetëgjatësisë" (shih rastet e GJEDNJ-së: *X kundër Francës*, nr. 18020/91, Aktgjykim i 31 marsit 1992, paragrafi 47; dhe *A dhe të tjerët kundër Danimarkës*, nr. 20826/92, Aktgjykim i 8 shkurtit 1996, paragrafët 78-81).

e) Rastet që lidhen me pretendimet për ushtrim të dhunës nga zyrtarët policorë (shih rastin e GJEDNJ-së: *Caloc kundër Francës*, nr. 33951/96, Aktgjykim i 20 korrikut 2000, paragrafi 120).

f) Në rastet kur mund të rrezikohet e drejta e edukimit (shih rastin e GJEDNJ-së: *Oršuš dhe të tjerët kundër Kroacisë*, nr. 15766/03, Aktgjykim i 16 marsit 2010, paragrafi 109).

g) Disa raste të tjera nuk kërkojnë vëmendje të shtuar, për shembull rastet që lidhen me kompensimin e dëmit të shkaktuar në aksidente rrugore, apo rastet që kanë të bëjnë me ndarjen e trashëgimisë ndërmjet trashëgimtarëve të personit të vdekur (shih rastet e GJEDNJ-së: *Nicolae Virgiliu Tanase kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 213; *Omdahl kundër Norvegjisë*, nr. 46371/18, Aktgjykim i 22 prillit 2021, paragrafi 63-64).

B. Aplikimi i parimeve në rrethanat e rastit konkret

(i) Periudha që do të merret parasysh

89. Gjykata, duke iu referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, ka vlerësuar se përllogaritja e shtrirjes në kohë të procedurave fillon në momentin kur gjykata kompetente vihet në lëvizje me kërkesë të palëve për vendosjen e një të drejte apo interesi legjitim të pretenduar (shih rastet e GJEDNJ-së: *Erkner dhe Hofauer kundër Austrisë*, nr. 9616/81, Aktgjykim i 23 prillit 1987, paragrafi 64; dhe *Poiss kundër Austrisë*, nr. 9816/82, Aktgjykim i 23 prillit 1987, paragrafi 50). Ky proces konsiderohet i përfunduar me nxjerrjen e një vendimi gjyqësor përfundimtar nga një instancë

kompetente gjyqësore e fundit (shih rastin e GJEDNJ-së: *Poiss kundër Austrisë*, cituar më lart, paragrafi 50).

90. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës, më 7 nëntor 2000, e kishte dorëzuar kërkesën për zbatimin e procedurës së trashëgimisë. Më 1 shkurt 2002, Gjykata Komunale, përmes Aktvendimit [T.nr.29/2000], e ndërpreu çështjen juridike lidhur me procedurën e trashëgimisë deri në përfundimin e procedurave në lëndët [Civ.nr.279/97] dhe [Civ.nr.314/2001]. Nga shkresat e lëndës rezulton se, që nga 1 shkurti 2002, procedura në rastin e parashtruesit të kërkesës vijon të jetë e ndërprerë.

91. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se, periudha që duhet marrë parasysh në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, sipas paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, llogaritet nga data e parashtrimit të kërkesës për zbatim të procedurës së trashëgimisë në Gjykatën Komunale, përkatësisht nga 7 nëntori 2000 dhe të njëjtat vazhduan të shqyrtoheshin para Gjykatës Themelore edhe pas 15 qershorit 2008, kur hyri në fuqi Kushtetuta, e deri më 1 prill 2025, kur parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesën e tij në Gjykatë, periudhë që gjithsej përfshin 24 (njëzetekatër) vjet, 4 (katër) muaj e 25 (njëzetepesë) ditë.

(ii) Parimet relevante

92. Gjykata, para së gjithash thekson se, sipas praktikës gjyqësore të konsoliduar të GJEDNJ-së, e cila është reflektuar edhe në praktikën e deritanishme gjyqësore të Gjykatës, arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të rastit, duke marrë parasysh kriteret e vendosura nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, përkatësisht kriteret që i referohen: (a) ndërlikueshmërisë së rastit; (b) sjelljes së palëve në procedurë; (c) sjelljes së gjykatës kompetente ose autoriteteve të tjera publike; si dhe (d) rëndësisë së asaj çfarë është në rrezik për parashtruesin në kontest (shih rastet e GJEDNJ-së: *Mikulić kundër Kroacisë*, cituar më lart, paragrafi 38; *Frydlender kundër Francës*, cituar më lart, paragrafi 41; dhe *Sürmeli kundër Gjermanisë*, nr. 75529/01, Aktgjykim i 8 qershorit 2006, paragrafi 128).

(iii) Analiza e arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës

93. Ashtu siç është elaboruar edhe më sipër, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës inicioi procedurën gjyqësore në Gjykatën Komunale përmes kërkesës për zbatimin e procedurës trashëgimore pas vdekjes së nënës së tij, [N.SH].

94. Në vijim të kësaj, për të konstatuar nëse kohëzgjatja e procedurës ka qenë e arsyeshme, Gjykata duhet të marrë parasysh faktorët si në vijim: (a) ndërlikueshmërinë e rastit; (b) sjelljen e parashtruesit të kërkesës; (c) sjelljen e autoriteteve relevante gjyqësore; dhe (d) rëndësinë e asaj çfarë është në rrezik për parashtruesin e kërkesës në kontest.

Ndërlikueshmëria e rastit

95. Përkitazi me ndërlikueshmërinë e rastit, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, përmes së cilës është theksuar se ndërlikueshmëria e rastit mund të ndërlidhet me çështje të faktit dhe të ligjit, por gjithashtu mund të ndërlidhet edhe me përfshirjen e disa palëve në procedurë apo me një numër të caktuar provash që duhet trajtuar para gjykatave të rregullta (shih rastet e GJEDNJ-së: *Katte Klitsche de la Grange kundër Italisë*, cituar më lart, paragrafi 55; *H. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 72; dhe *Humen kundër Polonisë*, nr. 26614/95, Aktgjykim i 15 tetorit 1999, paragrafi 63). Po ashtu, sipas GJEDNJ-së, në rastet kur një procedurë nuk

është komplekse, mungesa e qartësisë dhe parashikueshmërisë në legjislacionin vendas mund ta vështirësojë zgjidhjen e rastit dhe të kontribuojë në kohëzgjatjen e procedurës (shih rastin e GJEDNJ-së: *Famullia Katolike Greke e Lupenit dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 150).

96. Në rastin konkret, Gjykata vëren se, ky rast është i lidhur me kërkesën e parashtruesit të kërkesës për zbatimin e procedurës së trashëgimisë, në bazë të së cilës rezultonte se përfshihen 14 (katërmbëdhjetë) trashëgimtarë të radhës së parë trashëgimore dhe sipas bazës së përfaqësimit. Ndërkaq, në bazë të shkresës së datës 27 mars 2025 të parashtruesit të kërkesës, përmes së cilës njoftohej Gjykata Themelore përkitazi me radhët e trashëgimisë si pasojë e vdekjes së disa prej trashëgimtarëve të trashëgimlënëses rezulton se numri i trashëgimtarëve sipas radhës së parë trashëgimore dhe sipas bazës së përfaqësimit është njëzetenëntë (29). Procedura në këtë çështje është ndërprerë si rezultat i dy procedurave kontestimore të iniciuara në Gjykatën Komunale, në të cilat janë të përfshira të njëjtat paluajtshmëri sikurse në masën trashëgimore. Të dy rastet në fjalë, [Civ.nr.279/97] dhe [C.nr.314/2001], si pasojë e së cilës është ndërprerë procedura jokontestimore, në bazë të përgjigjes së Gjykatës Themelore në Gjakovë, nuk rezultojnë të kenë përfunduar me vendim të formës së prerë, duke ndikuar kështu në ndërlikueshmërinë e rastit.

Sjellja e parashtruesit të kërkesës

97. Gjykata thekson se parashtruesit e kërkesave në parim kanë të drejtë të ndjekin të gjithë hapat proceduralë të vënë në dispozicion nga ligjet në fuqi. Megjithatë, parashtruesit e kërkesave duhet të kenë parasysh gjithashtu pasojat në rast se mjetet ligjore të shfrytëzuara mund të ndikojnë në kohëzgjatjen e shqyrtimit të rastit të tyre. Gjykata konsideron se, sjellja e parashtruesve të kërkesave përbën një fakt objektiv që nuk mund t'u atribuohet gjykatave dhe që duhet marrë parasysh në konstatimin nëse procedurat vazhduan më gjatë sesa afati i arsyeshëm kohor, i garantuar me paragrafin 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së (shih rastet e GJEDNJ-së: nr. 31333/06, Aktgjykim i 10 shtatorit 2010, paragrafi 148; *Eckle kundër Gjermanisë*, nr. 8130/78, Aktgjykim i 15 korrikut 1982, paragrafi 82).

98. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka shfrytëzuar mjetet juridike në dispozicion, ankesën ndaj Aktvendimit [T.nr.29/2000] të Gjykatës Komunale, përmes të cilit është ndërprerë procedura. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton qëndrimin e GJEDNJ-së se parashtruesit e kërkesave nuk mund të kritikohen për përdorimin e plotë të mjeteve juridike të disponueshme sipas ligjit të aplikueshëm (shih rastin e GJEDNJ-së: *Eckle kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 82).

99. Lidhur me veprimet procedurale të parashtruesit të kërkesës, Gjykata i referohet praktikës së GJEDNJ-së ku kishte sqaruar se parashtruesve të kërkesës u kërkohet të tregojnë kujdes në ndërmarrjen e hapave proceduralë dhe për t'u përmbajtur nga përdorimi i taktikave të vonimit të shqyrtimit të rastit të tyre (shih rastin e GJEDNJ-së: *Bara dhe Kola kundër Shqipërisë*, nr. 43391/18 17766/19, Aktgjykim i 12 tetorit 2021, paragrafi 91, ku GJEDNJ-ja kishte konstatuar se bazuar në sjelljen e ankuesit nuk ka tregues se ai ka shkaktuar apo kontribuar në zvarritje të procedurave).

100. Parashtruesi i kërkesës, bazuar në shkresat e lëndës, kërkoi nga Gjykata Komunale, më pas Gjykata Themelore, përmes tri (3) kërkesave, që të zhvillohet procedura e ndërprerë, dhe atë: (i) më 2 tetor 2009, përmes parashtresës së natyrës së urgjencës drejtuar Kryetarit të Gjykatës Komunale, parashtruesi i kërkesës kërkoi që të zhvillohet procedura e lartcekur në lëndën e iniciuar në vitin 2000; (ii) më 27 mars 2025, parashtruesi i kërkesës përmes parashtresës e njoftoi Gjykatën Themelore se nga

paraqitja e kërkesës për shqyrtimin e trashëgimisë, kanë vdekur edhe një pjesë e trashëgimtarëve të trashëgimlënëses [N.SH], specifikoi renditjen e trashëgimtarëve të mbetur dhe kërkoi caktimin e seancës për shqyrtim të trashëgimisë; si dhe (iii) më 8 prill 2025, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata Themelore që me urgjencë ta caktojë seancën.

101. Prandaj, Gjykata, duke u bazuar në veprimet e lartcekura të parashtruesit të kërkesës që nga data e parashtrimit të padisë, konsideron se veprimet e parashtruesit të kërkesës nuk mund të kenë ndikuar në vonesën e gjykatave të rregullta, respektivisht në shqyrtimin e rastit të tij.

Sjellja e autoriteteve relevante gjyqësore

102. Gjykata fillimisht vë në dukje qëndrimin parimor të GJEDNJ-së se paragrafi 1 i nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së kërkon nga shtetet kontraktuese që të organizojnë sistemet e tyre ligjore në mënyrë të atillë që autoritetet kompetente të përmbushin kërkesat e nenit në fjalë, duke përfshirë edhe detyrimin për të shqyrtuar çështjet brenda një afati të arsyeshëm kohor (shih rastet e GJEDNJ-së: *Luli dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, nr. 64480/09 64482/09, 12874/10, 56935/10, 3129/12, Aktgjykim i 1 prillit 2014, paragrafi 91; *Abdoella kundër Holandës*, nr. 12728/87, Aktgjykim i 25 nëntorit 1992, paragrafi 24; dhe *Mishgjoni kundër Shqipërisë*, nr. 18381/05, Aktgjykim i 7 dhjetorit 2010.

103. Në këtë kontekst, GJEDNJ kishte theksuar se nuk mund të merret në konsideratë arsyetimi i gjykatave për mbingarkesën me lëndë të pazgjidhura (shih rastet e GJEDNJ-së: *Bara dhe Kola kundër Shqipërisë*, cituar më lart, paragrafët 70-71 dhe 94-96; dhe *Vocaturo kundër Italisë*, cituar më lart, paragrafi 17).

104. Gjykata rikujton se, që nga 1 shkurti i vitit 2002, përmes Aktvendimit [T.nr.29/2000], Gjykata Komunale e ka ndërprerë çështjen juridike lidhur me procedurën e trashëgimisë deri në përfundimin e procedurave në lëndët [Civ.nr.279/97] dhe [Civ.nr.314/2001], që ndërlidhen me ngastrat kadastrale të specifikuara në propozimin e parashtruesit të kërkesës për zbatimin e procedurës trashëgimore. Ndërkaq, Gjykata e Qarkut në Pejë e ka lënë në fuqi këtë Aktvendim, pasi e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës.

105. Siç është sqaruar edhe nga Gjykata, me qëllim të pasqyrimit të plotë të fakteve, Gjykata i është drejtuar dy (2) herë me kërkesë për informata shtesë Gjykatës Themelore, duke drejtuar pyetje specifike përkitazi me arsyet e ndërprerjes së procedurës së parashtruesit të kërkesës, statusit procedural të çështjeve juridike kontestimore, si pasojë e të cilave është ndërprerë procedura jokontestimore, si dhe pengesave që kjo Gjykatë ka hasur përderisa nga viti 2002 nuk ka vazhduar procedurën e ndërprerë, në një lëndë të iniciuar që nga viti 2000.

106. Gjykata, në bazë të përgjigjeve të deponuara nga Gjykata Themelore, vëren se arsye e mosvijimit të trajtimit të lëndës së parashtruesit të kërkesës korrespondon të jetë fakti se dy lëndët kontestimore, të cilat po ashtu janë të iniciuara në Gjykatën Themelore në Gjakovë, nuk kanë përfunduar me vendim të formës së prerë.

107. Nga përgjigjet e Gjykatës Themelore nuk sqarohet nëse është ndërmarrë ndonjë hap qoftë procedural, qoftë i natyrës informative, përkitazi me dy çështjet juridike kontestimore, të cilat do t'i hapnin rrugë vazhdimit të procedurës jokontestimore. Njëherësh, nuk pasqyrohet nëse ka pasur komunikim ndërinstitucional përkitazi me këto lëndë. Në këto përgjigje vetëm pasqyrohet fakti se nuk ka vendim të formës së prerë dhe se shkresat e këtyre lëndëve janë arkivuar.

108. Gjykata rikujton se, më 29 janar 2020, [M.SH] ka paraqitur padi për vërtetim të së drejtës së pronësisë në paluajtshmërinë e cila evidentohet në emër të [N.SH], si trashëgimlënëse e palëve paditëse. Në këtë lëndë [C.nr.93/20], më 2 maj 2025, në këtë lëndë është ndërprerë procedura deri në vendosjen e formës së prerë të lëndës [T.nr.29/2000]. Përderisa, lënda jokontestimore është ndërprerë deri në përfundimin e çështjeve juridike të natyrës kontestimore, ku lënda [Civ.nr.314/2001] ka për objekt kontesti po ashtu vërtetimin e të drejtës së pronësisë, Gjykata vëren diskrepancë të veprimeve procedurale brenda Gjykatës Themelore, përderisa rezulton që çështja juridike kontestimore [C.nr.93/20] është ndërprerë si pasojë e çështjes së parashtruesit të kërkesës që rezulton të jetë jokontestimore, për procedimin e së cilës parashtruesi i kërkesës ka mbi 23 (njëzetetre) vjet që pret Gjykatën Themelore, si pasojë e mospërfundimit me vendim të formës së prerë të dy çështjeve juridike të natyrës kontestimore.

109. Gjykata rikujton edhe faktin se, parashtruesi i kërkesës, më 8 prill 2025, ka kërkuar nga gjykatat që me urgjencë të caktohet seanca, kërkesë për të cilën bazuar në përgjigjet e Gjykatës Themelore, akoma nuk është vendosur dhe parashtruesi i kërkesës nuk ka marrë përgjigje.

110. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se çështja e parashtruesit të kërkesës është në procedurë gjyqësore që nga viti 2000, gjegjësisht për më tepër se 24 (njëzetekatër) vjet, dhe se lënda rezulton të jetë e ndërprerë nga 1 shkurti i vitit 2002, respektivisht mbi 23 (njëzetetre) vjet.

111. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se ndikim në kohëzgjatjen e procedurave ka pasur mospërfundimi me vendim të prerë i dy çështjeve juridike kontestimore. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton se gjykatat nuk mund të lejojnë që rastet gjyqësore të mbeten pafundësisht të pazgjidhura në një instancë gjyqësore dhe se periudha prej më tepër se 24 (njëzetekatër) vitesh në pritje të zgjidhjes së lëndës civile në fjalë u atribuohet organeve gjyqësore.

(d) Rëndësia e asaj çfarë rrezikon parashtruesi i kërkesës në kontest

112. Lidhur me kriterin e asaj çfarë rrezikon parashtruesi i kërkesës në kontest, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, e cila sqaron se një kategori e rasteve kërkon zgjidhje të veçantë ekspeditive. Sipas kësaj praktike, shembuj që kërkojnë kujdes të veçantë dhe zgjidhje me prioritet janë rastet që ndërlidhen me statusin dhe kapacitetin civil, rastet rreth kujdestarisë së fëmijëve dhe marrëdhënies prind-fëmijë, kontestet nga marrëdhënia e punës, rastet e parashtruesve që vuajnë nga "sëmundje të pashërueshme" dhe kanë "pritje të reduktuar të jetëgjatësisë", si dhe rastet rreth të drejtës për arsim (shih rastin e GJEDNJ-së: *Frydlender kundër Francës*, cituar më lart, paragrafi 45).

113. Rrjedhimisht, Gjykata, bazuar në praktikën e konsoliduar gjyqësore të GJEDNJ-së, thekson se kërkesa për zbatimin e procedurës së trashëgimisë nuk është çështje që kërkon *"kujdes të posaçëm"* siç janë shembujt e lartcekur të vlerësuar nga GJEDNJ si kategori e çështjeve që kërkojnë zgjidhje e prioritet.

Përfundim lidhur me kohëzgjatjen e procedurave

114. Nga sa më sipër, Gjykata konstaton se: (i) rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me një kontest të procedurës jokontestimore që ka për objekt zbatimin e procedurës së trashëgimisë; (ii) parashtruesi i kërkesës nuk ka kontribuar në tejzgjatjen e procedurës përmes veprimeve të tij, dhe (iii) për më tepër se 24 (njëzetekatër) vjet, çështja e

parashtruesit të kërkesës nuk ka marrë epilog, meqë procedura është ndërprerë dhe rrjedhimisht kjo vonesë është e pajustifikueshme.

115. Thënë këtë, Gjykata konstaton se, në rrethanat e parashtruesit të kërkesës, ka shkelje të së drejtës së parashtruesit të kërkesës për gjykim brenda një afati kohor të arsyeshëm, të garantuar me paragrafin 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

116. Gjykata, bazuar në konstatimin e mësipërm për shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, thekson se, Gjykata Themelore në Gjakovë duhet të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm proceduralë për të evituar pengesat që procedimin e mëtejmë të lëndës [T.nr.29/2000] dhe për t'i dhënë epilog.

Përkitazi me kërkesën për kompensim

1. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës ka kërkuar kompensim në shumën prej 10,000.00 (dhjetëmijë) euro *"në emër të kompensimit dëmit jomaterial – dhembjeve shpirtrore për shkelje të drejtës në gjykim në një proces të drejtë, neni 6, i KEDNJ dhe nenit 31 e drejta për gjykim të drejtë dhe të pa anëshëm*".

2. Lidhur me këtë, Gjykata ka ripërsëritur se nuk ka autorizime ligjore për caktimin e ndonjë lloji të kompensimit për rastet në të cilat konstaton shkelje të Kushtetutës dhe KEDNj-së si pasojë e tejzgjatjes së procedurave gjyqësore (shih rastet KI19/21, parashtrues *Sadik Pllana*, cituar më lart, paragrafi 115; KI06/21, cituar më lart, paragrafi 84; dhe KI64/23, *cituar më lart*, paragrafi 104).

3. Gjykata përsërit se, në disa raste, gjetja e shkeljes kushtetuese paraqet një lloj të "*shpërblimit të drejtë*", sidomos kur parashtruesi ka mundur të pësojë një dëm jomaterial. Megjithatë, individët mund të kërkojnë dëmshpërblim nga autoritetet publike në rast të konstatimit të shkeljes së të drejtave dhe lirive të tyre kushtetuese. Në rastet kur vetëm konstatimi i shkeljes nuk mjafton dhe kompensimi monetar është i domosdoshëm, individët kanë të drejtë të përdorin mjetet juridike në dispozicion për realizimin e të drejtave të tyre, përfshirë kompensimin e dëmit material dhe jomaterial pranë gjykatave të rregullta (shih rastet e Gjykatës: KI113/21, parashtruese *Bukurije Haxhimurati*, Aktgjykim i 20 dhjetorit 2021, paragrafët 145-151; dhe KI06/21, parashtrues *Dragan Mihajlović*, cituar më lart, paragrafi 85.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, në nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullin 48 (1) (a) të Rregullores së punës, më 11 dhjetor 2025, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkitazi me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm;

III. TË URDHËROJË Gjykatën Themelore në Gjakovë që, më së largu deri më 11 mars 2026, të informojë Gjykatën Kushtetuese lidhur me masat e ndërmarra për zbatimin e këtij Aktgjykimi, në përputhje me paragrafin 5 të Rregullit 60 të Rregullores së Punës;

IV. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;

V. Ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Radomir Laban Nexhmi Rexhepi